



Nr/Br. 600/19
Data/Datum. 23.10.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
PRISHTINË - PRIŠTINA



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 600/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.SH.“Eni-Design” – Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontrate Grupi i OE “Arhiko.ing”OP dhe “P.M.N.”SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve Detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Lipjan (KK-LIPJAN), më datën 10.10.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.SH.“Eni-Design” – Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve Detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan (KK-LIPJAN).

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës kontratë, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Hartimi i Projekteve Detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan (KK-LIPJAN) dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.SH.“Eni-Design” – Gjilan, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë me dt: 24.04.2019

Hapja e ofertave dt: 06.05.2019

Njoftimi me letër standarde dt: 21.08.2019

Njoftimi mbi pezullimin e vendimit me dt: 22.08.2019

Njoftimi mbi anulimin e pezullimit të vendimit me dt: 28.08.2019

Kërkesë për rishqyrtim me dt: 02.09.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 04.09.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.N.SH.“Eni-Design” – Gjilan, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.09.2019 me nr. 600/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE-ve “Arhiko.ing”OP dhe “P.M.N.”SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i Projekteve Detale”, me numër të prokurimit: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan (KK-LIPJAN), duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69, 72 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- Neni 20, 27, dhe 39.8 të UOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.09.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 04.10.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës:

Ankesa e OE “ENI Design” nr.600/19 ka 4 pretendime ankimore:

1. Mos dhënia e qasjes nga AK në dokumente

2. Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga AK si e jashtë afatshme
3. Falsifikimi i certifikatës ISO nga OE i rekomanduar për kontratë
4. Tërheqja e anëtarit të konzorciumit P.M.N SH.P.K (Ofrimi i dokumenteve pa autorizimin e OE)

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, për mos dhënie të qasjes në dokumente zyrtare, pas hulumtimit në platformën E Prokurimit kemi gjetur se OE ENI Design me datë 22.08.2019 ka bërë kërkesë për qasje në dokumente pranë AK-së.

Të njëjtën datë 22.08.2019 pas njoftimit të PMN SHPK për tërheqje nga konzorciumi, AK ka bërë pezullimin e vendimit për shpalljen e fituesit ku thuhet “ky vendim mbetet në fuqi derisa të sqarohet kjo situatë nga lideri i konzorciumit”.

Pas vendimit të fundit të datës 28.08.2019 prapë nuk kemi gjetur dëshmi se AK i ka lejuar qasje OE ankues, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Pas kërkit dhe analizimit të dokumenteve në platformën E Prokurimi nuk kemi gjetur dëshmi se AK ka lëshuar vendimin në kërkesë për rishqyrtim të OE ankues.

Me gjithë këtë përmes ankesës të parashtruar në OSHP, OE ankues ENI Design deklaron se arsyeja e AK-së për mos shqyrtim të kërkesës ka qenë se kërkesa është e jashtë afatshme.

Pas analizimit të shkresave vlerësojmë se vendimi i fundit i AK-së për shpallje të fituesit është ai i datës 28.08.2019 ndërsa kërkesa për rishqyrtim e OE është bërë me 02.09.2019, që do të thotë ditën e pestë.

Bazuar në dispozitat ligjore vlerësojmë se kërkesa e OE ankues për rishqyrtim është bërë brenda afatit ligjorë siç është paraparë me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar dhe kërkesa për rishqyrtim është bërë brenda afatit të paraparë ligjorë.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Pretendimi ankimorë ku OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë falsifikim të ISO certifikatës, sqarojmë se pas qasjes në faqen zyrtare të lëshuesit të certifikatës King Cert, nuk kemi mundur të gjejmë certifikatën e kontestuar nga OE ankues, dhe në këtë mënyrë nuk kemi mund të bëjmë krahasim me certifikatën e ofruar në ofertë të OE fitues në ofertën e tij.

Lidhur me këtë pretendim ankimorë për fund sqarojmë se ekspertit shqyrtues i OSHP-së nuk ka autorizim apo kompetenca për të dhënë përgjigje në pretendime ankimorë kur pretendimet ankimore janë për falsifikim të dokumenteve.

Përgjigje në pretendimin nr.4

Pretendimi i radhës (dhe kryesor) ankimorë është se Lideri ka ofruar “...Ne këtë fazë Operatori Ekonomik PMN SH.P.K. si pjese e grupit te OE ne konzorcium me OE fitues ka dërguar një letër ne bazë te të cilës ai tërhiqet nga grupi për arsye se OE ka dorëzuar dokumentet e tyre pa autorizim dhe duke falsifikuar te gjitha nënshkrimet ne dokumente ka dorëzuar ofertën ...”.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, në platformën E Prokurimit kemi gjetur njoftimin e dërguar nga PMN SHPK të cilin njoftim kompania deklaron :

*“Kompania P.M.N SH.P.K. me seli në Prishtinë ju njofton se **VERTETIMI i ATK-së dhe VERTETIMI i GJYKATËS** që janë dorëzuar ditën e djeshme nga persona të pa-autorizuar nga kompania jonë, janë dokumente të kopjuara në forma jo-legjitime dhe pa lejen e kompanisë P.M.N. SH.P.K.*

*Si Operator Ekonomik me të drejta të rezervuara në lidhje me dokumentacionin personal, **kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të tërhejë dokumentet e lartpërmendura të cilat ne si kompani përgjegjëse për dokumentacionin tonë i konsiderojmë jovalide.***

*Pasi që Operatori Ekonomik që kemi qenë në koncorzium, ka bërë shkelje ligjore duke shfrytëzuar dokumentacionin tonë pa leje paraprake, si kompani vendosim të **TËRHIQEMI NGA KONCORZIUMI.** ”*

Nga ky njoftim i OE “PMN SHPK”, pretendon se vërtetimi i ATK dhe vërtetimi i Gjykatës janë dorëzuar nga persona të paautorizuar nga kompania. Mirëpo në këtë njoftim OE PMN SH.P.K. NUK pretendon se i gjithë dokumentacioni i tij është falsifikuar ashtu siç pretendon OE:“ENI Design”.

Lidhur me këtë pretendim ankimorë duhet theksuar se sipas Marrëveshjes Partneritetit, e po ashtu sipas Deklaratës për obligim kontraktues dokumente këto që gjenden në ofertë të OE rekomanduar për kontratë, lider i grupit është caktuar OE: “Arhiko” i cili është autorizuar të veproj në emër të grupit, andaj në rast se dokumentet si vërtetimi i ATK dhe vërtetimi i gjykatës janë dorëzuar nga OE Arhiko vlerësojmë se kjo nuk përbën asnjë shkelje sepse i njëjti është autorizuar nga vet OE PMN SH.P.K. të veproj në emër të grupit, kjo nënkupton edhe ofrimin e çfarëdo dokumenteve që kërkohen nga AK.

Me gjithë këtë, fakti që OE:“PMN” SH.P.K. me njoftimin e datës 22.08.2019 deklaron se tërhiqen nga konzorciumi, vlerësojmë se bënë ofertën e grupit “Arhiko & PMN” të papranueshme, sepse si pasojë e tërheqjes tani kemi të bëjmë me ndryshim/modifikim të grupit, gjë e cila decidivisht ndalohet me nenin 27 të RRUOPP-së.

Neni 27.5 i RRUOPP-së:

*"OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit, **Grupi operatorëve nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet.**"*

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet e bazuar** (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 07.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.10.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankues, ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës të njëjtit nuk u paraqiten në seancë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Zekaj deklaroj: Ne si OE pajtohemi me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues në të gjitha pretendimet dhe kemi vetëm të shtojmë vetëm tek pretendimi i dytë ku pretendimi jonë ka qenë se janë falsifikuar dokumentet zyrtare kemi të shtojmë se ne si OE kemi menduar se Autoriteti Kontraktues do të bëjë kërkesën drejt OSHP-së në lidhje me dokumentet e falsifikuar mirëpo nuk e kanë bërë, ne i kemi sjellë të dy dokumentet me vete dhe si prove i dorëzojmë panelit shqyrtues dhe shihet pjesa e falsifikuar të njëjtat janë të dorëzuar edhe përmes e-mailit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovon ankesën tonë të bazuar dhe të kthehet lënda në rivlerësim

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli

shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për mos dhënie të qasjes në dokumente zyrtare. Paneli shqyrtues konstaton se pas hulumtimit në platformën E Prokurimit kemi gjetur se OE ENI Design me datë 22.08.2019 ka bërë kërkesë për qasje në dokumente pranë AK-së. Të njëjtën datë 22.08.2019, pas njoftimit të PMN SHPK për tërheqje nga konzorciumi, AK ka bërë pezullimin e vendimit për shpalljen e fituesit ku thuhet “ky vendim mbetet në fuqi derisa të sqarohet kjo situatë nga lideri i konzorciumit”, ndërsa pas kërkit dhe analizimit të dokumenteve në platformën E Prokurimi nuk kemi gjetur dëshmi që tregon se OE ankues i është lejuar qasja në dokumente, e as dëshmi se AK ka lëshuar vendimin në kërkesë për rishqyrtim të OE ankues, e që në pajtim me nenin 10 të LPP-së AK është i obliguar që ti lejoj qasje OE në dokumente menjëherë pas kërkesës së bere nga OE, po ashtu neni 6 i Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, e obligon AK-në që të bej pezullimin e aktivitetit te prokurimit në fjalë në te cilin nen thuhet: Pezullimi i aktivitetit te prokurimit 6.1 Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe ne këtë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet te njoftoj me shkrim te gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit ne fjale.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron arsyeja e AK-së për mos shqyrtim të kërkesës parashtruar nga OE ankues ENI Design , se kërkesa ka qenë e jashtë afatshme, është i pa qëndrueshëm ky arsyetim i AK - së për faktin se pas analizimit të shkresave vlerësojmë se vendimi i fundit i AK-së për shpallje të fituesit është ai i datës 28.08.2019 ndërsa kërkesa për rishqyrtim e OE është bërë me 02.09.2019, që do të thotë ditën e pestë. Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore vlerësojmë se kërkesa e OE ankues për rishqyrtim është bërë brenda afatit ligjorë siç është paraparë me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar dhe kërkesa për rishqyrtim është bërë brenda afatit të paraparë ligjorë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë falsifikim të ISO certifikatës. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pas qasjes në faqen zyrtare të lëshuesit të certifikatës King Cert, eksperti shqyrtues profesional nuk ka mundur të gjejë certifikatën e kontestuar nga OE ankues, dhe në këtë mënyrë nuk kemi mund të bëjmë krahasim me certifikatën e ofruar në ofertë të OE fitues në ofertën e tij, andaj me rastin e rivlerësimit AK duhet te verifikoj këto dëshmi dhe te vërtetoj se dëshmitë e kontestuar nga ana ankuesit, ashtu siç u cekën me lart a janë në pajtim me

kërkesën e autoriteti kontraktues apo jo. Paneli shqyrtues lidhur me pretendimet e ankuesit që kanë të bëjnë me falsifikim të dokumenteve nga ana e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës konstaton se autoriteti kontraktues nëse vërteton se dëshmitë e pretenduara nga ankuesi për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës ku pretendohet se janë të falsifikuara dhe konstatohet se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar me dokumente të falsifikuara apo të rreme, në pajtim me nenin 99.2 të LPP-se AK është e obliguar që të inicioj procedurë ndaj këtij OE në OSHP.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se lideri ka ofruar “Në këtë fazë Operatori Ekonomik PMN SH.P.K. si pjesë e grupit të OE në konzorcium me OE fitues ka dërguar një letër në bazë të të cilës ai tërhiqet nga grupi për arsye se OE ka dorëzuar dokumentet e tyre pa autorizim dhe duke falsifikuar të gjitha nënshkrimet në dokumente ka dorëzuar ofertën ...”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se pas analizimit të shkresave të lëndës, në platformën E Prokurimit kemi gjetur njoftimin e dërguar nga PMN SHPK të cilin njoftim kompania deklaron: “Kompania P.M.N SH.P.K. me seli në Prishtinë ju njofton se VERTETIMI i ATK-së dhe VERTETIMI i GJYKATËS që janë dorëzuar ditën e djeshme nga persona të pa-autorizuar nga kompania jonë, janë dokumente të kopjuara në formë jo-legjitime dhe pa lejen e kompanisë P.M.N. SH.P.K.

Si Operator Ekonomik me të drejta të rezervuara në lidhje me dokumentacionin personal, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të tërhejë dokumentet e lartpërmendura të cilat ne si kompani përgjegjëse për dokumentacionin tonë i konsiderojmë jovalidë. Pasi që Operatori Ekonomik që kemi qenë në konzorcium, ka bërë shkelje ligjore duke shfrytëzuar dokumentacionin tonë pa leje paraprake, si kompani vendosim të TËRHIQEMI NGA KONCORZIUMI.”

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se nga ky njoftim i OE “PMN SHPK”, ku pretendon se vërtetimi i ATK dhe vërtetimi i Gjykatës janë dorëzuar nga persona të paautorizuar nga kompania. Mirëpo në këtë njoftim OE PMN SH.P.K. NUK pretendon se i gjithë dokumentacioni i tij është falsifikuar ashtu siç pretendon OE: “ENI Design”. Andaj lidhur me këtë pretendim ankimorë duhet theksuar se sipas Marrëveshjes Partneritetit, e po ashtu sipas Deklaratës për obligim kontraktues dokumente këto që gjenden në ofertë të OE rekomanduar për kontratë, lider i grupit është caktuar OE: “Arhiko” i cili është autorizuar të veprojë në emër të grupit, andaj në rast se dokumentet si vërtetimi i ATK dhe vërtetimi i gjykatës janë dorëzuar nga OE Arhiko vlerësojmë se kjo nuk përbën asnjë shkelje sepse i njëjti është autorizuar nga vet OE PMN SH.P.K. të veprojë në emër të grupit, kjo nënkupton edhe ofrimin e çfarëdo dokumenteve që kërkohen nga AK.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoritari kontraktues duhet të analizoj faktin që OE: “PMN” SH.P.K. me njoftimin e datës 22.08.2019 deklaron se tërhiqen nga konzorciumi dhe me

rastin e rivlerësimit AK duhet te veproj ne pajtim me nenin 27 të RRUOPP ndaj OE "Arhiko & PMN", ku në nenin 27.5 të RRUOPP thuhet: "*Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet. Nëse gjate fazës se ekzekutimit tërhiqet njeri anëtar i grupit, përbërja e grupit nuk mund te ndryshohet pa pëlqimin e AK. Ne këtë rast AK duhet te shqyrtoj nëse kriteret e përzgjedhjes vazhdojnë te përmbushen*".

Paneli shqyrtues vjen në përfundim qe ta kthej këtë lende ne rivlerësim pasi qe AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, ku fare nuk ja ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim te Operatoritekonomik ankues. Paneli shqyrtues sqaron se edhe pse lënda kthehet ne rivlerësim konform pika 6 te nenit 116 te LPP-së "*Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar*".

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Lipjan,
- 1x1 OE – N.N.SH."Eni-Design" – Gjilan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.